



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE PËR PËRFAQËSUESET E KOSOVËS

Prishtinë, 2024

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## PËRMBAJTJA

<b>DISPOZITAT THEMELORE .....</b>	<b>4</b>
NENI 1 - Qëllimi.....	4
NENI 2 - Përfaqësueset e basketbollit .....	4
NENI 3 - Fanellat dhe Pajisjet Sportive .....	5
NENI 4 - Përbërja e Përfaqësueseve .....	5
NENI 5 - Sistemi dhe Kalendari i Garave në FBK .....	6
<b>OBLIGIMET E KLUBEVE .....</b>	<b>6</b>
NENI 6 - Obligimet Themelore.....	6
NENI 7 - Përgjegjësia në rast të mospjesëmarrjes/vonesës.....	7
NENI 8 - Obligimet e trajnerëve të klubeve .....	7
<b>OBLIGIMET E LOJTARËVE .....</b>	<b>8</b>
NENI 9 - E drejta e angazhimit për Përfaqësuesen .....	8
NENI 10 - Obligimet themelore.....	8
NENI 11 - Ftesa.....	9
NENI 12 - Abstenimi për Pjesëmarrje .....	10
NENI 13 - Përgjegjësia Disiplinore.....	10
NENI 14 - Kompensimi për shpenzime.....	11
NENI 15 - Pajisjet sportive .....	11
NENI 16 - Aspekti mediatik/promovues .....	11
NENI 17 - Përfaqësueset e Kategorive të Reja .....	12
<b>Menaxheri, PËRZGJEDHËSIT DHE SHTABET PROFESIONALE TË PËRFAQËSUESEVE 13</b>	
NENI 18 - Menaxheri i Përfaqësueseve .....	13
NENI 19 - Përzgjedhësit e Përfaqësueseve .....	13
NENI 20 - Planet e Punës për Përfaqësueset .....	14
NENI 21 - Raportimi tek Bordi i FBK-së.....	14
NENI 22 - Respektimi i akteve normative të FBK-së dhe FIBA-s .....	15
NENI 23 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Përzgjedhësve .....	15
<b>PËRZGJEDHËSI I PËRFAQËSUESEVE A (SENIOR).....</b>	<b>16</b>
NENI 24 - Emërimi.....	16
NENI 25 - Shkarkimi para skadimit të afatit kohor .....	16

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNERS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





<b>PËRZGJEDHËSIT E PËRFAQËSUESEVE TJERA .....</b>	<b>17</b>
NENI 26 - Emërimi dhe shkarkimi i Përfaqësueseve të tjera .....	17
<b>SHTABET PROFESIONALE TË PËRFAQËSUESEVE SHTETËRORE .....</b>	<b>17</b>
NENI 27 - Përbërja e Shtabit Profesional .....	17
NENI 28 - Përgjegjësia disiplinore .....	18
NENI 29 - Kompensimet.....	18
<b>DELEGACIONI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS DHE UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT .....</b>	<b>19</b>
NENI 30 - Udhëheqësi i Delegacionit.....	19
<b>DISPOZITAT E TJERA .....</b>	<b>20</b>
NENI 31 - Komunikimi me Mediat dhe Publikun .....	20
NENI 32 - Sigurimi i anëtarëve të Përfaqësueseve .....	21
NENI 33 - Mirënjohjet dhe shpërblimet monetare.....	21
<b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....</b>	<b>21</b>
NENI 34 - Udhëzimet e Bordit të FBK-së .....	21
NENI 35 - Ndryshimet dhe Interpretimi .....	21
NENI 36 - Hyrja në Fuqi.....	22
<b>SHTOJCA 1 .....</b>	<b>23</b>
<b>TRAJNERËT DHE NDIHMËS-TRAJNERËT E PËRFAQËSUESEVE TË GJENERATAVE TË REJA .....</b>	<b>23</b>
Kualifikimet dhe aftësitë:.....	23
Kontrata për Punë dhe Detyra Specifike: .....	24
Pagesa: .....	24
Bonuset: .....	25
Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit: .....	25
Punët, detyrat dhe përgjegjësitë e trajnerëve të Përfaqësueseve të Reja: ..	26
<b>SHTOJCA 2 .....</b>	<b>29</b>
<b>SHTABI PROFESIONAL DHE UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT .....</b>	<b>29</b>
MJEKU/DOKTORI .....	29
FIZIO-TERAPEUTI .....	30
TRAJNERI KONDICIONAL .....	32
UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT .....	33

**Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNER JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





Në bazë të Nenit 23, alineja 1.14 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, me datë 08.05.2024, miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR PËRFAQËSUESET E KOSOVËS

### DISPOZITAT THEMELORE

#### NENI 1 - Qëllimi

Me Rregulloren për Përfaqësuese të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), përcaktohen:

- Kategoritë dhe emërtimet e Përfaqësueseve;
- Obligimet e klubeve përballë Përfaqësueseve;
- Obligimet e basketbollistëve/basketbollisteve ndaj Përfaqësueseve;
- Menaxheri, përzgjedhësit dhe shtabet profesionale të Përfaqësueseve;
- Delegacioni i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe udhëheqësit e rrugës të Përfaqësueseve;
- Kodi i Sjelljes në Përfaqësueset shtetërore.

#### NENI 2 - Përfaqësueset e basketbollit

**1.** Përfaqësueset e basketbollit e përfaqësojnë Republikën e Kosovës, Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe sportin kosovar në garat dhe paraqitjet ndërkombëtare.

**2.** Të qenit pjesë e Përfaqësueseve të Kosovës në basketboll është nder dhe obligim i secilit basketbollist dhe basketbolliste, secilit anëtar të shtabit profesional, si dhe të çdo anëtari tjetër të FBK-së.

**3.** Është obligim i secilit anëtar të FBK-së që të siguroj kushte optimale për punë dhe suksese të Përfaqësueseve. Suksesi i Përfaqësueseve është prioritet për FBK, në veçanti kur bëhet fjalë për kalendarin e garave zyrtare të FIBA-s.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP PRINETS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





#### 4. Me emërtimin Përfaqësuese nënkuptohet:

- a. Përfaqësuesja A Meshkujt;
- b. Përfaqësuesja A Femrat;
- c. Përfaqësuesja U20 Meshkujt;
- d. Përfaqësuesja U20 Femrat;
- e. Përfaqësuesja U18 Meshkujt;
- f. Përfaqësuesja U18 Femrat;
- g. Përfaqësuesja U16 Meshkujt;
- h. Përfaqësuesja U16 Femrat;
- i. Përfaqësuesja U14 Meshkujt;
- j. Përfaqësuesja U14 Femrat.

5. FBK sipas nevojës mund të krijoj edhe Përfaqësuese të tjera (si: U15, mesdhetare, studentore, ushtarake, policore, etj.), por assesi klubi, apo ndonjë klub i qytetit apo regjionit nuk mund të emëroj veten Përfaqësuese dhe të garoj me këtë emër.

### NENI 3 - Fanellat dhe Pajisjet Sportive

1. Ngjyrat përfaqësuese në fanella dhe veshmbathje të tjera sportive të Përfaqësueseve janë kaltër, verdhë dhe bardhë.
2. Stema shtetërore e Republikës së Kosovës, logo e FBK-së, logo e FIBA-s dhe logot e sponsorëve vendosen sipas manualit të FIBA-s.

### NENI 4 - Përbërja e Përfaqësueseve

1. Përfaqësuesen e përbëjnë: lojtarët e përzgjedhur, përzgjedhësi, Menaxheri dhe anëtarët e shtabit profesional, si dhe gjyqtari në rast se delegohet nga FIBA.
2. Në rast se gjyqtari është anëtar i Përfaqësueses sipas alinesë paraprake të këtij neni, ka të drejta dhe obligime të ngjashme me anëtarët e Përfaqësueses (shpenzimet e transportit dhe akomodimit).

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





**3.** Gjyqtarët për turne dhe ndeshjet miqësore i delegon Bordi i FBK-së në bazë të propozimit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës, përpos në rastet kur ata i delegon FIBA.

## **NENI 5 - Sistemi dhe Kalendari i Garave në FBK**

**1.** Sistemi i garave në të gjitha garat e FBK-së do të përgatitet dhe miratohet në koordinim të plotë me kalendarin e garave zyrtare të FIBA-s në interes të Përfaqësueseve të Kosovës.

**2.** Nëse paraqitja zyrtare e klubit përrupthet me obligimet e Përfaqësueses në të cilën është zgjedhur, lojtari i atij klubi që ka të drejtë të kërkoj shtyrjen e ndeshjes së vet (për Kupë apo Kampionat) dhe atë për tërë kohën sa lojtari është me Përfaqësuesen. Lojtarit të përzgjedhur në Përfaqësuese nuk i lejohet që në kohën e aktiviteteve të Përfaqësueses të luaj nëpër turne me klubin e vet, përpos në raste kur këtë e lejon Menaxheri i Përfaqësueseve.

## **OBLIGIMET E KLUBEVE**

### **NENI 6 - Obligimet Themelore**

**1.** Është obligim i çdo klubi, amator apo profesional, që për zbatimin e programit të aktiviteteve të Përfaqësueses, të vë në dispozicion të FBK-së të gjithë lojtarët e përzgjedhur si dhe tërë potencialin profesional dhe potencialin tjetër në arritjet e sukseseve të Përfaqësueses.

**2.** Obligim i secilit klub, amator apo profesional është që t'i përmbahet kalendarit të miratuar nga Bordi i FBK-së.

**3.** Anëtarit (basketbollistit, trajnerit, mjekut, fizioterapeutit, ekonomit, etj.) të përzgjedhur në Përfaqësuese, klubi është i obliguar që ti mundësoj pjesëmarrjen në programin, duke përfshirë përgatitjet, ndeshjet miqësore dhe garat e Përfaqësueseve.

#### **Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



BP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





**4.** Klubi përgjatë kohës që lojtari, trajneri, fizioterapeuti, ekonomi, etj. janë të angazhuar në Përfaqësuese, nuk ka të drejtë të mos paguajë për arsyen se ka qenë i angazhuar në Përfaqësuese.

## **NENI 7 - Përgjegjësia në rast të mospjesëmarrjes/vonesës**

- 1.** Nëse për mospjesëmarrjen apo vonesën e lojtarëve ose të ndonjë tjetër anëtarit të Përfaqësueses në grumbullimet e Përfaqësueses përgjegjës është klubi, atëherë do të dënohet klubi konform Rregullores Disiplinore të FBK-së.
- 2.** Gjatë garave zyrtare të kalendarit të FIBA-s në rast se klubi e ndalon lojtarin për të mos u paraqitur në Përfaqësuese, klubi në fjalë do të ndëshkohet konform akteve normative në fuqi të FBK-së dhe FIBA-s.

## **NENI 8 - Obligimet e trajnerëve të klubeve**

Trajneri i klubit të caktuar nga i cili është ftuar lojtari i asaj skuadre për Përfaqësuese (trajneri i skuadrës nga i cili vjen lojtari i ftuar) duhet që të ketë bashkëpunim me Përzgjedhësin e Përfaqësueses, të realizoj plan-programin kur e kërkon Përzgjedhësi, mos t'i bëhet pengesë lojtarit që të shkoj në stërvitje me Përfaqësuese. Në rast të mos-përmbajtjes së këtij obligimi, rasti do trajtohet si cenim i unitetit dhe disiplinës brenda përfaqësueses dhe do dënohet konform Rregullores Disiplinore të FBK-së.

### **Kosovo Basketball Federation**

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## OBLIGIMET E LOJTARËVE

### NENI 9 - E drejta e angazhimit për Përfaqësuesen

1. Për Përfaqësuesen e Kosovës mund të angazhohen shtetasit e Kosovës dhe lojtarët me dy shtetësi konform rregullave të FIBA-s.
2. Pjesë e Përfaqësueses nuk mund të jetë lojtari i suspenduar, i dënuar ose që kundër tij zhvillohet procedurë disiplinore. Në raste të veçanta, me kërkesë e përzgjedhësit, organi i cili zhvillon procedurën disiplinor, mund ta heq suspendimin, gjegjësisht ta shtyjë procedurën disiplinore.

### NENI 10 - Obligimet themelore

1. Lojtari i Përfaqësueses së Kosovës është i obliguar ta përfaqësoj Kosovën dhe basketbollin e Kosovës në gara ndërkombëtare. Lojtari i Përfaqësueses së Kosovës është i obliguar të kontribuoj me tërë dijen dhe angazhimin e vet maksimal për arritjen e rezultateve sa më të mira të Përfaqësueses, dhe të aplikoj rregullat e basketbollit dhe rregullat e 'FAIR PLAY', si dhe duhet të jetë shembull me sjelljet e tij të mira brenda dhe jashtë fushës së lojës.
2. Në përgatitjet dhe ndeshjet e Përfaqësueses të Kosovës, lojtari i përzgjedhur është i obliguar t'i përmbahet udhëzimeve dhe urdhërësive për stërvitje, ndeshje, qëndrimin në përgatitje, udhëzimeve për shfrytëzimin e pajisjeve, udhëzimeve për ushqim dhe barna, si dhe udhëzimeve të tjera të cilat i parashtron shtabi teknik dhe Përzgjedhësi i Përfaqësueses.
3. Gjatë stërvitjeve, lojtari duhet:
  - (a) të respektojë oraret e stërvitjes siç janë përcaktuar nga trajnerët;
  - (b) të paraqitet në fushën e stërvitjes, i veshur me uniformë sportive, në kohën e caktuar përpara fillimit të stërvitjes;
  - (c) t'i binden udhëzimeve të trajnerit dhe të japin maksimumin e tyre të mundshëm, në mënyrë që ata të arrijnë nivel sa më të lartë individual e grupor.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:







4. Jashtë garave dhe stërvitjeve, lojtari duhet:
  - (a) të ndjek udhëzimet e trajnerëve dhe Menaxherit të Përfaqësueseve, në lidhje me akomodimin dhe çështje të tjera;
  - (b) të kujdesen për dietën e tyre, duke ndjekur, nëse është e mundur, planin e dietës që u është rekomanduar.
5. Çdo mjekim ose substancë suplementare e administruar që ata marrin, përveç atyre të administruara nga mjekë, fiziologë profesionistë, nutricionistë, duhet të deklarohen me shkrim.
6. Në përputhje me rregulloret e FIBA dhe FIBA Evropës, lojtarët e Përfaqësueses janë të detyruar t'i nënshtrohen testeve anti-doping, sa herë që kërkohet nga autoritetet kompetente.
7. Përveç kësaj, lojtarët e Përfaqësueses duhet të kenë qasje shembullore ndaj përfaqësuesve të autoriteteve sportive, tifozëve dhe çdo pale të tretë dhe vazhdimisht të promovojnë sportin e basketbollit dhe vlerat e sportit në përgjithësi.

## NENI 11 - Ftesa

1. Pas përcaktimit të listës së lojtarëve për kandidat të ndonjërës Përfaqësuese, Menaxheri i Përfaqësueseve, me shkresë fton lojtarët e përzgjedhur për bashkë-marrje në punën e Përfaqësueses. Ftesa i dorëzohet lojtarit, klubit, apo edhe federatës, në garat e të cilës merr pjesë dhe konform afateve të përcaktuara nga FIBA. Ftesa duhet të bëhet nëpërmjet adresave zyrtare të FBK-së.
2. Ftesa për lojtarin përmban programin e përgatitjeve dhe ndeshjeve, kohën dhe vendin e grumbullimit, si dhe obligimet e lojtarit.
3. Lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për përgatitje dhe ndeshje të Përfaqësueses. Me marrjen e ftesës për pjesëmarrje në Përfaqësuese krijohen obligimet për lojtarin dhe klubin e tij.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## NENI 12 - Abstenimi për Pjesëmarrje

**1.** Abstenimi për pjesëmarrje në Përfaqësuese mund të bëhet vetëm me arsye dhe dëshmi. Shkaqe të arsyeshme, ndër të tjera, konsiderohen: rastet e vdekjes ose sëmundjes së rëndë në familje, lëndimi i rëndë ose sëmundja e lojtarit. Shkallën e lëndimit ose të sëmundjes së lojtarit e përcakton mjeku i Përfaqësueses ose Komisioni Mjekësor i caktuar nga FBK.

**2.** Në rast të abstenimit, lojtari i ftuar është i obliguar që me shkrim ta njoftoj përzgjedhësin përmes Menaxherit të Përfaqësueses. Abstenimin me shkrim, në afat prej 48 orësh nga pranimi ftesës mund ta paraqes edhe klubi në vend të lojtarit. Nëse rrethanat për abstenim krijohen pas marrjes së ftesës, lojtari, gjegjësisht klubi janë të obliguar që me shkrim menjëherë ta njoftojnë përzgjedhësin përmes Menaxherit të Përfaqësueses.

**3.** Lojtari i cili abstenon nga pjesëmarrja në Përfaqësuese për shkak të lëndimit ose sëmundjes, është i obliguar që këtë ta paraqesë me shkrim, kurse bashkë me shkresën duhet të paraqesë tërë dokumentacionin mjekësor lidhur me lëndimin apo sëmundjen e tij. Nëse mjeku ose Komisioni Mjekësor i Përfaqësueses vlerësojnë se lojtari duhet kontrolluar nga ana e tyre, lojtari është i obliguar t'i përgjigjet ftesës për kontrollim të mëtejshëm. Në rast se lojtari nuk i përgjigjet ftesës për kontroll të mëtejshëm, do të konsiderohet se mungesa e tij është e paarsyeshme.

## NENI 13 - Përgjegjësia Disiplinore

**1.** Ndaj lojtarit i cili pa arsye vonohet ose nuk i përgjigjet ftesës për grumbullim, ose që gjatë përgatitjeve me veprimet e tij dëmton autoritetin e Përfaqësueses, do të iniciohet procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të FBK-së. Në raste të dyshimit të bazuar për kundërvajtje për të cilën me Rregullore Disiplinore të FBK-së parashihet dënimi me mos-lojë deri në një vit, përzgjedhësi i Përfaqësueses, duke iniciuar procedurë disiplinore, propozon pezullimin e lojtarit. Në rast të shqiptimit të masës së

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



BIP FINANCE JOINT VENTURE

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





pezullimit, në bazë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, lojtari i pezulluar nuk ka të drejtë loje për Përfaqësuesen e as për klubin e tij, gjatë tërë kohës së pezullimit.

**2.** Përpos dënimit me mos-lojë, për kundërvajtjen e vonesës së paarsyeshme, mos përgjigjes për grumbullim dhe paraqitje për Përfaqësuese, lojtari mund të dënohet me vendim të Bordit të FBK-së me të holla prej 500 deri 2000 EUR. Në rast të mos pagesës së dënimit me të holla nga ana e lojtarit, Komesari i Garave mund t'i shqiptoj ndalesë me mos-lojë të lojtarit, derisa të paguhet dënimi i shqiptuar.

**3.** Për masën e pezullimit, masën e ndalesës për lojë ose dënim me të holla njoftohet zyra e FIBA-s, nëse këtë e vlerëson të nevojshme Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, por patjetër kur është në pyetje lojtari që luan për ndonjë klub jashtë vendit, ose është duke realizuar të drejtën e kalimit në një klub jashtë vendit.

## NENI 14 - Kompensimi për shpenzime

Për fazën përgatitore dhe për ndeshje, lojtarit i takon kompensimi për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit, dhe kompensimi ditor (per diem) në lartësi të përcaktuar me vendim të Bordit të FBK-së.

## NENI 15 - Pajisjet sportive

FBK siguron pajisjen sportive për secilën Përfaqësuese për lojtarët, përzgjedhësin dhe shtabin profesional të Përfaqësueses. Të gjithë anëtarët e Përfaqësueses janë të obliguar t'i mbajnë pajisjet gjatë tërë kohës së aktivitetit të Përfaqësueses, të cilat i përcakton dhe siguron FBK.

## NENI 16 - Aspekti mediatik/promovues

Gjatë fushatës së Përfaqësueses, lojtarët janë të detyruar të marrin pjesë në të gjitha fushatat e marketingut, promovimit, bamirësisë apo fushata reklamuese të FBK-së dhe sponsorëve të saj, pa pagesë të veçantë, dhe të

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





të jenë të pranishëm në të gjitha konferencat për shtyp dhe aktivitetet mediatike në të cilat kërkohet prania e tyre.

## NENI 17 - Përfaqësueset e Kategorive të Reja

- 1.** Gjatë përgatitjeve, ndeshjeve përgatitore dhe garave zyrtare, lojtarët dhe përfaqësuesit e kategorive të reja duhet t'u përmbahen të gjitha kufizimeve me kontaktet e jashtme të vendosura nga FBK, Menaxheri i Përfaqësueseve apo shtabi profesional.
- 2.** Kjo është veçanërisht e vërtetë për kontaktet me agjentët dhe menaxherët. Në këtë drejtim, FBK mund të vendos masa, përkatësisht çdo gjë që nga paralajmërimi, konfiskimi i përkohshëm i celularit, laptopit apo pajisjeve të tjera të komunikimit e deri te përjashtimi i përkohshëm nga Përfaqësuesja.
- 3.** Kontakti me prindërit është i lejuar, por nuk lejohet që prindërit të ndërhyjnë në asnjë mënyrë në autonominë profesionale të FBK-së, drejtimin e përfaqësueses dhe shtabin profesional.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## MENAXHERI, PËRZGJEDHËSIT DHE SHTABET PROFESIONALE TË PËRFAQËSUESEVE

### NENI 18 - Menaxheri i Përfaqësueseve

1. Menaxherin e Përfaqësueseve e emëron dhe shkarkon Bordi i FBK-së.
2. Menaxheri mund të emërohet për ndonjë aktivitet konkret apo për një periudhë kohore-cikël. Periudha kohore mund të zgjat më së shumti 4 vite me të drejtë rizgjedhje pa kufizim.
3. Menaxheri i Përfaqësueses është përgjegjës për të gjitha çështjet organizative, financiare dhe teknike të Përfaqësueseve.
4. Menaxheri bashkëpunon ngushtë me Sekretarin e Përgjithshëm të FBK-së dhe për punën e tij i përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm dhe Bordit të FBK-së.
5. Në rast nevojë, Menaxheri mund të kërkojë që Bordi të emëroj Koordinator të Përfaqësueseve për Femra apo Koordinator të Përfaqësueseve për të Rinj.
6. Menaxheri, ndër të tjera, duhet të ketë:
  - Përvojë në basketboll si lojtar ose trajner;
  - Të ketë aftësi organizative dhe të marketingut;
  - Të flasë së paku një gjuhë zyrtare të FIBA-s.

### NENI 19 - Përzgjedhësit e Përfaqësueseve

1. Secila Përfaqësuese nga neni 2 i kësaj Rregullore ka përzgjedhësin të cilin e emëron Bordi i FBK-së me propozim të Këshillit Profesional dhe në bashkëpunim me Menaxherin e Përfaqësueseve dhe Drejtorin Teknik të FBK-së.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





2. Statusi, të drejtat dhe detyrat e përzgjedhësit, më për së afërmi përcaktohen me kontratë pune për periudhën e caktuar, për të cilën emërohen nga Bordi i FBK-së.
3. Përzgjedhësi emërohet për ndonjë aktivitet të Përfaqësueses, kualifikime, gara ose për ndonjë periudhë kohore-cikël.
4. Me vendimin e Bordit të FBK-së për emërimin e përzgjedhësit përcaktohet edhe statusi juridiko-punues i përzgjedhësit, gjegjësisht përcaktohet se me përzgjedhësin do të nënshkruhet kontratë, ku do precizohet periudha për kohën sa përzgjedhësi do të paguhet nga FBK, forma e pagesës dhe detajet e tjera.

## NENI 20 - Planet e Punës për Përfaqësueset

1. Me rastin e emërimit të përzgjedhësve të Përfaqësueseve, secili prej tyre në afat kohor prej një muaji që nga data e emërimit do të dorëzojë Planin e Punës për Përfaqësuesen që është emëruar.
2. Plani i Punës duhet të dorëzohet tek Këshilli Profesional, ndërsa është Menaxheri i Përfaqësueseve, i cili së bashku me Këshillin Profesional e mbikëqyr punën e përzgjedhësit dhe programin e punës së tij.
3. Menaxheri i Përfaqësueseve dhe Këshilli Profesional në baza javore e mujore e informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për ecurinë e Planit të Punës të përzgjedhësit.
4. Listën e gjerë për çdo përfaqësuese e përcakton Përzgjedhësi i Përfaqësueses nën mbikëqyrjen nga Këshilli Profesional dhe Menaxherit të Përfaqësueseve.

## NENI 21 - Raportimi tek Bordi i FBK-së

Me të përfunduar aktiviteti i Përfaqësueses, përzgjedhësi është i obliguar edhe me kontratë të raportojë tek Bordi i FBK-së. Nëse Përzgjedhësi nuk e

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





dorëzon raportin tek Bordi, atëherë Bordi do t'i referohet neneve të kontratës, në të cilat janë të precizuara ndëshkimet në rast të mos-përbushjes së detyrave.

## **NENI 22 - Respektimi i akteve normative të FBK-së dhe FIBA-s**

Përzgjedhësit dhe shtabet profesionale të Përfaqësuesve janë të obliguara t'i përmbahen Statutit të FBK-së, kësaj Rregullore, dhe të gjitha akteve normative tjera të FBK-së (me theks të veçantë Rregulloren Disiplinore dhe Kodin Etik të FBK-së). E njëjta vlen për të gjitha aktet normative të FIBA-s.

## **NENI 23 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Përzgjedhësve**

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Përzgjedhësit, ndër të tjera, janë:

- Bashkëpunojnë në hartimin e Planit të Punës të aktivitetit të Përfaqësueses;
- Përcaktojnë planin e aktiviteteve konkrete të Përfaqësueses;
- Propozojnë listën e gjerë të kandidatëve për çdo aktivitet dhe garë;
- Përcaktojnë listën e ngushtë të anëtarëve të Përfaqësueses për çdo aktivitet dhe garë;
- Në mënyrë profesionale udhëheqin stërvitjet dhe ndeshjet e Përfaqësueses;
- Përgatisin plane dhe programe individuale për punë të anëtarëve të Përfaqësuesesve nëpër klube dhe mbikëqyrin realizimin e tyre;
- Përcjellin përparimin ose zhvillimin e basketbollistëve të rinj, kandidatë potencial;
- Marrin pjesë në punën e Këshillit Profesional kur është e nevojshme;
- Paraqesin raport me shkrim për përgatitjet dhe ndeshjet në afat prej 30 ditësh, pas përfundimit të përgatitjeve apo aktiviteteve dhe garave të mbajtura.
- Së bashku me ndihmësit e tyre dhe i raportojnë për punën e tyre Këshillit Profesional dhe Menaxherit të Përfaqësuesesve të Kosovës;

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







- Marrin pjesë në takime të ftuara nga Bordi i FBK-së, dhe trupave të tjera të FBK-së kur shqyrtohen tema profesionale me interes për Përfaqësuesen.
- Për më shumë detaje, shih **Shtojca 1** bashkëngjitur kësaj Rregullore.

## PËRZGJEDHËSI I PËRFAQËSUESEVE A (SENIOR)

### NENI 24 - Emërimi

1. Përzgjedhësi i Përfaqësueses A (Senior) Meshkujt apo Femrat emërohet nga Bordi i FBK-së për periudhën të cilën ia cakton Bordi.
2. Për përzgjedhës të Përfaqësueses mund të përzgjidhet personi që përpos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësoj edhe këto kushte:
  - Së paku të ketë titullin e trajnerit të lartë të basketbollit;
  - Të ketë rezultate të larta me klube të cilësisë së lartë;
  - Të flasë njërën nga gjuhët zyrtare të FIBA-s.

### NENI 25 - Shkarkimi para skadimit të afatit kohor

1. Përzgjedhësi i Përfaqësueses A mund të shkarkohet nga detyra dhe para skadimit të afatit kohor që është emëruar:
  - a. Nëse për shkak të jo-efikasitetit të realizimit të Planit të Punës kanë munguar rezultatet e pritura;
  - b. Nëse me veprimet e veta dëmton autoritetin e basketbollit kosovar, FBK-në e veçanërisht autoritetin e Republikës së Kosovës;
  - c. Për shkaqe të parapara me ligj ose kontratë në mes të përzgjedhësit dhe FBK-së.
2. Në rast të shkarkimit nga detyra e përzgjedhësit, të dorëheqjes ose në raste të tjera, Bordi i FBK-së me propozimin e Këshillit Profesional emëron ushtruesin e detyrës ose përzgjedhësin e ri të Përfaqësueses në konkurrencën e seniorëve.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







## PËRZGJEDHËSIT E PËRFAQËSUESEVE TJERA

### NENI 26 - Emërimi dhe shkarkimi i Përfaqësuesve të tjera

1. Të gjithë Përzgjedhësit e Përfaqësuesve të tjera sipas nenit 2 të kësaj Rregullore i emëron Bordi i FBK-së me propozim të Këshillit Profesional.
2. Përzgjedhësit duhet të jenë:
  - Trajner i licencuar në FBK;
  - Të jetë i dëshmuar me sukses në kategorinë gjegjëse;
  - Të jetë trajner me kualifikime të larta apo me shkollim superior të basketbollit;
  - Të njohë së paku një gjuhë zyrtare të FIBA-s.
3. Përzgjedhësi mund të shkarkohet nga detyra edhe para skadimit të afatit kohor që është emëruar:
  - Nëse për shkak të jo-efikasitetit të realizimit të Planit të Punës kanë munguar rezultatet e pritura;
  - Nëse me veprimet e veta dëmton autoritetin e basketbollit kosovar, FBK-në e veçanërisht autoritetin e Republikës së Kosovës;
  - Për shkaqe të parapara me ligj ose kontratë në mes të përzgjedhësit dhe FBK-së.

## SHTABET PROFESIONALE TË PËRFAQËSUESEVE SHTETËRORE

### NENI 27 - Përbërja e Shtabit Profesional

1. Përpos përzgjedhësit të Përfaqësueses, formohet Shtabi Profesional në të cilin bën pjesë një ose më shumë trajnerë, trajneri kondicional, mjeku dhe fizioterapeuti.
2. Përzgjedhësi i Përfaqësueses mund të kërkoj nga Menaxheri i Përfaqësueses që t'i sigurohet bashkëpunëtori-trajneri.
3. Anëtarët e Shtabit Profesional i emëron Bordi i FBK-së me propozimin e përzgjedhësit, ndërsa mjekun dhe fizioterapeutin i emëron Menaxheri i

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





Përfaqësueses me rekomandim paraprak të Shoqatës së Mjekësisë Sportive që vepron në basketbollin kosovar.

**4.** Trajnerët dhe fizioterapeutët e Përfaqësueses bashkëpunojnë në punën e Përfaqësueses prej momentit të grumbullimit deri në përfundim të çfarëdo aktiviteti apo garë.

**5.** Mjekët e Përfaqësueses bashkëveprojnë në punën me Përfaqësuesen prej fillimit të garimit ose sipas nevojës, kurse me Përfaqësuesen A senior të meshkujve veprojnë prej momentit të grumbullimit të ekipit për aktivitet të veçantë gjegjësisht garë të veçantë. Mjekët dhe fizioterapeutët e Përfaqësueses bashkëpunojnë me mjekët dhe fizioterapeutët e klubeve, mbikëqyrin gjendjen shëndetësore dhe propozojnë trajtim shëndetësor të kandidatëve për Përfaqësuese, si dhe mbajnë evidencën shëndetësore të tyre.

## NENI 28 - Përgjegjësia disiplinore

Ndaj përzgjedhësit ose anëtarit të shtabit profesional i cili gjatë punës me Përfaqësuese me veprimet e veta e dëmton autoritetin e FBK-së ose basketbollit, Bordi i FBK-së inicion procedurë disiplinore për dëmtimin e autoritetit të FBK-së, ose basketbollit kosovar në tërësi. Përveç dënimit kohor të kryerjes së detyrës, personi mund të dënohet edhe me të holla në shumë prej 500 deri në 5000 EURO.

## NENI 29 - Kompensimet

Përzgjedhësve dhe anëtarëve të Shtabeve Profesionale u takojnë kompensimet për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit dhe kompensimet ditor (*per diem*) në lartësi të përcaktuar me vendim të Bordit të FBK-së.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNER JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## DELEGACIONI I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS DHE UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT

### NENI 30 - Udhëheqësi i Delegacionit

1. Pjesë përbërëse e secilit delegacion të Përfaqësueseve duhet të jetë udhëheqësi i delegacionit (konform rregullave të FIBA-s), të cilin e emëron Bordi i FBK-së me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm. Udhëheqësi i delegacionit paraqet dhe përfaqëson interesat dhe kërkesat e FBK-së dhe Përfaqësueses para organizatorëve si dhe para zyrtarëve të FIBA-s në garë.
2. Udhëheqësi i delegacionit duhet ti përmbahet në përpikëri Udhëzuesit dhe Kodit të Etikës të FIBA-s. Udhëheqësi i delegacionit është përgjegjës për Përfaqësuesen prej fillimit e deri në përfundim të aktivitetit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë:
  - a. Përgjegjësi për të gjithë delegacionin që nga nisja në kampionat/aktivitet zyrtar deri në kthimin nga jashtë vendit.
  - b. Të jetë gjithmonë në dispozicion të shtabit profesional për ndihmë organizative.
  - c. Përgjegjës për zgjidhjen e komplikimeve organizative.
  - d. T'i raportojë çdo ditë Menaxherit të Përfaqësueseve apo Koordinatorit përkatës për atë që ndodh në kampionat apo gara të tjera zyrtare; në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme duhet të informojë personalisht edhe Sekretarin e Përgjithshëm të FBK-së.
  - e. Kujdeset të ofrojë kushtet më të mira të mundshme të punës, në mënyrë që shtabi profesional të merret sa më shumë vetëm me basketboll.
  - f. Për më shumë detaje, shih **Shtojca 2** bashkëngjitur kësaj Rregullore.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





**4.** Me kontratën për punë dhe detyra specifike do të precizohet periodha për kohën sa Udhëheqësi i Delegacionit do të paguhet nga FBK, për formën e pagesës dhe të gjitha detajet tjera financiare.

**5.** Udhëheqësve të delegacionit u takojnë kompensimet për shpenzime të rrugës, shpenzimet e qëndrimit.

## DISPOZITAT E TJERA

### NENI 31 - Komunikimi me Mediat dhe Publikun

**1.** Për hir të një imazhi të qartë dhe të organizuar të FBK-së dhe përfaqësueseve të Kosovës, të gjithë anëtarët e delegacioneve (përfshirë lojtarët) të secilës prej përfaqësueseve duhet të respektojnë rregullat e komunikimit si në vijim:

- a.** Të gjithë anëtarët e delegacioneve mund të komunikojnë me përfaqësues të mediave në ngjarje publike, si dhe ngjarje ose raste që nuk janë të destinuara për publikun e gjerë, por kanë të bëjnë me FBK-në ose rolin e anëtarëve të delegacioneve, vetëm me konfirmimin paraprak të udhëheqësit të delegacionit dhe Menaxherit të Përfaqësueseve.
- b.** Të gjithë anëtarët e delegacioneve janë të detyruar të komunikojnë me Departamentin për Media të FBK-së, përkatësisht me qëllim të marrjes së deklaratave, intervistave, xhirimeve dhe aktiviteteve të tjera mediatike.
- c.** Për çfarëdo ndryshimi në ekip (lëndime lojtarësh, mungesa, ndodhi të ndryshme...) së pari duhet informuar FBK dhe jo ndonjë përfaqësues i mediave. Nëse Shtabet profesionale nuk respektojnë këtë dispozitë, do merren masa ndaj tyre konform akteve normative të FBK-së dhe kontratave në fuqi.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## NENI 32 - Sigurimi i anëtarëve të Përfaqësueseve

1. Lojtarët, përzgjedhësit dhe anëtarët e shtabeve profesionale gjatë kohës së përgatitjeve ose të garave të Përfaqësueseve të Reja në rast se lëndohen, FBK i merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të tyre.
2. Lojtarët e Përfaqësueses A gjatë garave zyrtare të FIBA-s e kanë të mbuluar sigurimin në momentin e hapjes së Dritareve në kuadër të garave kualifikuese, apo para-kualifikuese për FIBA EuroBasket apo FIBA Kupa e Botës, konform rregullave të FIBA-s.

## NENI 33 - Mirënjohjet dhe shpërblimet monetare

Lojtarëve, përzgjedhësit dhe shtabi profesional mund t'i ndahen mirënjohje dhe shpërblime monetare/bonuse, për rezultatet e arritura në gara. Lartësinë e shpërblimit e përcakton Bordi i FBK-së, kurse shpërblimet individuale i propozon Përzgjedhësi. Bordi i FBK-së mund të vendos të shpërblejë me të holla edhe persona të tjerë për të cilët vlerësohet se janë meritore për suksesin e Përfaqësueses.

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### NENI 34 - Udhëzimet e Bordit të FBK-së

Bordi i FBK-së përmes udhëzimeve përcakton: standardet për të gjitha Përfaqësueset, për numrin e lojtarëve, shtabet profesionale, numrin e anëtarëve të Përfaqësueses, numrin e ditëve për përgatitje, vendosjen, stërvitjet, transportin, llojin e pajisjeve sportive, etj. Bordit udhëzimet ia propozon Menaxheri i Përfaqësueseve në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm.

### NENI 35 - Ndryshimet dhe Interpretimi

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në mënyrë dhe procedurë sikur me rastin e miratimit të saj.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

## 2. Interpretimin e kësaj Rregullore e bën Bordi i FBK-së.

### NENI 36 - Hyrja në Fuqi

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Miratuar në Prishtinë, më 08.05.2024

Arben FETAHU  
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## SHTOJCA 1

### TRAJNERËT DHE NDIHMËS-TRAJNERËT E PËRFAQËSUESEVE TË GJENERATAVE TË REJA

#### Kualifikimet dhe aftësitë:

TRAJNER	NDIHMËS-TRAJNER
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përvojë e mëparshme si trajner kryesor në basketboll, preferohet në nivelin ndërkombëtar ose profesionist;</li> <li>- Njohuri të thella të lojës dhe strategjive në basketbollit;</li> <li>- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe udhëheqjes, duke përfshirë aftësinë për të motivuar dhe frymëzuar lojtarët;</li> <li>- Përvojë në planifikimin dhe zbatimin e sesioneve të trajnimit të personalizuara për nevojat e individëve dhe ekipit në përgjithësi;</li> <li>- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe vendimmarrëse për të përmirësuar strategjitë dhe taktikat e lojës;</li> <li>- Fleksibilitet dhe aftësi për të menaxhuar situata të papritura dhe presionin gjatë lojërave të rëndësishme;</li> <li>- Përvojë e mëparshme në bashkëpunimin me stafin e ekipit dhe menaxhimin e dinamikave të grupit;</li> <li>- Diplomaci dhe aftësi për të përfaqësuar ekipin përballë mediave dhe publikut në mënyrë profesionale dhe të efektshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përvojë e mëparshme si trajner apo lojtar në basketboll në një nivel të lartë;</li> <li>- Njohuri të thella të lojës dhe strategjive në basketbollit;</li> <li>- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi, si dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor;</li> <li>- Aftësi të shkëlqyera të organizimit dhe menaxhimit të kohës;</li> <li>- Përkushtimi ndaj zhvillimit dhe përmirësimit të aftësive të lojtarëve;</li> <li>- Fleksibilitet dhe gatishmëri për të mësuar dhe për të punuar në një mjedis dinamik;</li> <li>- Diplomaci dhe aftësi për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie pozitive me lojtarët dhe shtabin profesional të Përfaqësueses.</li> </ul>

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNERS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







## Kontrata për Punë dhe Detyra Specifike:

Në bazë të vendimit të Bordit të FBK-së për emërimin e trajnerëve të përfaqësueseve dhe pas procesit të përzgjedhjes së ndihmës trajnerëve, FBK lidh marrëveshje ose kontratë për punë dhe detyra specifike me trajnerët dhe ndihmës-trajnerët e emëruar, e cila, ndër të tjera, përcakton:

- Kategorinë e përfaqësueses përkatëse me të cilën do të punojnë trajnerët dhe ndihmës-trajnerët;
- Kohëzgjatjen e bashkëpunimit;
- Ndërprerjen/shkëputjen e parakohshme e kontratës;
- Punët, detyrat dhe përgjegjësitë;
- Lartësinë dhe formën e pagesës për punën e kryer, si dhe kompensimin e shpenzimeve eventuale të udhëtimit/transportit;
- Shumën e bonuseve eventuale.

## Pagesa:

Për punën e kryer trajnerët mund të marrin pagesë në shumën neto të mëposhtme:

Kategoria	Trajneri		Ndihmës-trajneri	
	Divizioni B	Divizioni C	Divizioni B	Divizioni C
<b>U 16</b>	600/muaj	600/muaj	400/muaj	400/muaj
<b>U 18</b>	600/muaj	600/muaj	400/muaj	400/muaj
<b>U 20</b>	700/muaj	700/muaj	500/muaj	500/muaj

**(a)** Në rast të konstatimit se trajneri nuk e ka kryer punën me cilësi të mjaftueshme, në shtrirjen e kërkuar dhe të pritshme, dhe se rezultatet e arritura të konkurrimit nuk janë brenda kufijve minimalë të pritshëm, Bordi i FBK-së mund të vendosë të zvogëlojë lartësinë bazë të pagesës nga 10-30%.

**(b)** Në rast se trajneri, në përputhje me këtë Rregullore, nuk i kthen pajisjet e Përfaqësueses që ka drejtuar, vlera e kësaj pajisjeje i zbritet nga vlera që ai do të kishte marrë për punën e kryer.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







## Bonuset:

Trajnerët mund të marrin edhe bonuse apo çmime për arritjet në garat ndërkombëtare, sipas skemës në vijim:

Renditja	Shuma totale	
	Divizioni B	Divizioni C
<b>Fitues</b>	4,000.00EUR	2,000.00EUR
<b>Vendi II</b>	2,000.00EUR	/
<b>Vendi III</b>	1,000.00EUR	/
<b>Vendi IV deri VIII</b>	1,000.00EUR	/

Shuma totale e bonusit do ndahet me përqindje, ku 40% i takon Trajnerit, nga 20% për secilin nga dy ndihmës-trajnerët dhe 20% për pjesën tjetër të shtabit profesional.

## Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit:

Trajnerët dhe ndihmës-trajnerët e përfaqësuesve të gjeneratave të reja kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit në lidhje me punën e kryer. Shpenzimet e udhëtimit rimbursohen në bazë të faturës së dorëzuar.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Punët, detyrat dhe përgjegjësitë e trajnerëve të Përfaqësueseve të Reja:

	<b>TRAJNERËT</b>	<b>NDIHMËS-TRAJNERËT</b>
<b>Përgatitja e programeve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- merr pjesë aktive në krijimin e planit të punës për përfaqësuesen përkatëse;</li> <li>- përgatit planin e aktiviteteve konkrete të Përfaqësueses;</li> <li>- përgatit programe individuale stërvitore për një rreth të ngushtë kandidatësh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- merr pjesë aktive në krijimin e planit të punës për përfaqësuesen përkatëse;</li> <li>- ndihmon në përgatitjen e një plani të aktiviteteve konkretet të Përfaqësueses;</li> <li>- ndihmon në përgatitjen e programeve individuale stërvitore për një rreth të ngushtë kandidatësh.</li> </ul>
<b>Detyrat rreth përzgjedhjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh lojtarë cilësorë për Përfaqësuesen;</li> <li>- propozon listën e gjerë të kandidatëve për çdo aktivitet dhe garë;</li> <li>- përcakton listën e ngushtë të anëtarëve të Përfaqësueses për çdo aktivitet dhe garë;</li> <li>- kërkon lojtarë të rinj dhe i sugjeron për përfshirje në procesin stërvitor;</li> <li>- regjistron problemet e lojtarëve dhe përpiqet t'i zgjidhë së bashku me prindërit e tyre;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ndihmon në përzgjedhjen e lojtarëve cilësorë për Përfaqësuesen;</li> <li>- kërkon lojtarë të rinj dhe i sugjeron për përfshirje në procesin stërvitor;</li> <li>- regjistron problemet e lojtarëve dhe përpiqet t'i zgjidhë së bashku me prindërit e tyre;</li> <li>- regjistron sukseset e lojtarëve.</li> </ul>

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PHARMAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





	<ul style="list-style-type: none"> <li>- regjistron sukseset e lojtarëve.</li> </ul>	
<p><b>Përgatitja e përfaqësueses</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përgjegjës dhe i pranishëm në të gjitha fazat përgatitore të Përfaqësueses dhe do të bashkëpunoj ngushtë me shtabin profesional për zhvillim sa më të mirë të fazave përgatitore dhe përfaqësimit sa më të mirë në garën përkatëse;</li> <li>- drejton stërvitjet;</li> <li>- kujdeset për rekuizitat e besuara nga FBK;</li> <li>- kujdeset për realizimin e stërvitjeve dhe përgatitjeve në përputhje me programin;</li> <li>- koordinon punën e gjithë shtabit profesional;</li> <li>- motivimi i lojtarëve dhe mbajtja e moralit të ekipit në një nivel të lartë, duke ofruar udhëzime dhe përkrahje në momentet e vështira;</li> <li>- mbrojtja dhe përfaqësimi i ekipit përpara mediave dhe publikut, duke përfshirë konferencat e shtypit dhe intervistat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- i pranishëm në të gjitha fazat përgatitore të Përfaqësueses përkatëse dhe do të bashkëpunoj ngushtë me shtabin profesional për zhvillim sa më të mirë të fazave përgatitore dhe përfaqësimit sa më të mirë në garën përkatëse;</li> <li>- ndihmon trajnerin në udhëheqjen e stërvitjeve;</li> <li>- kujdeset për rekuizitat e besuara nga FBK;</li> <li>- kujdeset për realizimin e stërvitjeve dhe përgatitjeve në përputhje me programin.</li> <li>- motivimi i lojtarëve dhe mbajtja e moralit të ekipit në një nivel të lartë, duke ofruar udhëzime dhe përkrahje në momentet e vështira;</li> <li>- mbrojtja dhe përfaqësimi i ekipit përpara mediave dhe publikut, duke përfshirë konferencat e shtypit dhe intervistat.</li> </ul>

**Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





<p><b>Punë profesionale-administrative</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- merr pjesë në përzgjedhjen e ndihmësve të tij;</li> <li>- mban ditar pune;</li> <li>- kujdeset për edukimin dhe aftësimin e tij profesional;</li> <li>- paraqet raport vjetor për punën e bërë në këshillin profesional në fund të sezonit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- mban shënime për pjesëmarrjen dhe shënime të tjera për lojtarët;</li> <li>- mban shënime për punën e kryer;</li> <li>- mbledh video të ekipeve dhe lojtarëve individualë dhe kujdeset për analizën e tyre;</li> <li>- asistimi në analizën e lojës dhe performancës së ekipit për të identifikuar pikat e dobëta dhe për të sugjeruar ndryshime strategjike;</li> <li>- monitoron lojën dhe zhvillimin e Përfaqësueseve të tjera;</li> <li>- kujdeset për edukimin dhe aftësimin e tij profesional.</li> </ul>
<p><b>Raportimi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përgatis raport të detajuar të punës për gjithë ecurinë e përgatitjeve dhe aktivitetit të Përfaqësueses, para dhe gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin/garën përkatëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- T'i ndihmoj trajnerit në përgatitjen e raportit të detajuar të punës për gjithë ecurinë e përgatitjeve dhe aktivitetit të Përfaqësueses, para dhe gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin/garën përkatëse.</li> </ul>

Miratuar në Prishtinë, më 08.05.2024

Arben FETAHU  
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



**Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## SHTOJCA 2

### SHTABI PROFESIONAL DHE UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT

#### Kontrata për Punë dhe Detyra Specifike:

Në bazë të vendimit të Bordit të FBK-së, FBK lidh marrëveshje ose kontratë për punë dhe detyra specifike me anëtarët e shtabit profesional dhe me udhëheqësin e delegacionit, e cila, ndër të tjera, përcakton:

- Kategorinë e përfaqësueses përkatëse me të cilën do punojnë;
- Kohëzgjatjen e bashkëpunimit;
- Ndërprerjen/shkëputjen e parakohshme e kontratës;
- Punët, detyrat dhe përgjegjësitë;
- Lartësinë dhe formën e pagesës për punën e kryer, si dhe kompensimin e shpenzimeve eventuale të udhëtimit/transportit;
- Shumën e bonuseve eventuale.

#### MJEKU/DOKTORI

Përgjegjës për sigurinë dhe kujdesin e shëndetit të lojtarëve të Përfaqësueses. Kjo përfshin diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin e dëmtimeve dhe sëmundjeve të mundshme që mund të ndodhin gjatë stërvitjeve, ndeshjeve dhe udhëtimeve ndërkombëtare.

- Diagnostikimi dhe trajtimi i dëmtimeve dhe sëmundjeve të lojtarëve të ekipit nëpërmjet metodave të ndryshme mjekësore dhe terapive të nevojshme;
- Sigurimi i kujdesit mjekësor për lojtarët përpara, gjatë dhe pas ndeshjeve;
- Bashkëpunimi me stafin trajnues për të siguruar që programet e trajnimit të jenë të sigurta për shëndetin e lojtarëve;
- Parandalimi i dëmtimeve duke ofruar këshilla për trajnimin e sigurt dhe teknikat e stërvitjes;

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANCE JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





- Monitorimi i gjendjes së shëndetit të përgjithshëm të lojtarëve dhe raportimi i ndonjë shqetësimi ose problemi mjekësor të vërejtur;
- Përgatitja dhe administrimi i dokumentacionit mjekësor për lojtarët, duke përfshirë kartat e shëndetit dhe dosjet e historisë mjekësore;
- Udhëzimi dhe këshillimi i lojtarëve në lidhje me dietën dhe mënyrën e jetesës për të mbështetur shëndetin dhe performancën e tyre sportive;
- Koordinimi me mjekët dhe specialistët e tjerë mjekësorë për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve më të rënda ose të komplikuar.

### **Kualifikimet dhe Aftësitë:**

- Gradë e licencuar e mjekësisë me specializim në sport, ortopedi, ose fusha të ngjashme të mjekësisë sportive.
- Përvojë pune në fushën e mjekësisë sportive, veçanërisht me ekipet sportive të nivelit të lartë, është e preferueshme.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi me trajnerët, lojtarët dhe shtabin profesional;
- Aftësi të shprehura për marrjen e vendimeve të shpejta dhe të zgjedhura në situata të rëndësishme shëndetësore;
- Përgatitje për të punuar në një ambient të stresit të lartë dhe në situata të paparashikuara gjatë ndeshjeve dhe udhëtimeve të ekipit.

## **FIZIO-TERAPEUTI**

Përgjegjës për menaxhimin e kujdesit të fizioterapisë dhe rikuperimit të lojtarëve të Përfaqësueses. Kjo përfshin trajtimin e dëmtimeve, forcimin e muskujve, dhe ndihmën në përmirësimin e performancës së lojtarëve.

- Ndjekja e detyrueshme e të gjitha seancave stërvitore dhe ndeshjeve të Përfaqësueses;
- Veprimet parandaluese (pjesëmarrja në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të zhvillimit fizik, masazh para dhe pas ndeshjeve dhe seancave stërvitore, fashimi, etj.);
- Ofrimi i trajtimit fizioterapeutik për të zvogëluar dhimbjen dhe rikuperuar lëndimet e lojtarëve;

### **Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



BP PRINCEPS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





- Zhvillimi dhe administrimi i programeve të ushtrimeve terapeutike për të forcuar muskujt dhe përmirësuar koordinimin e lojtarëve;
- Pjesëmarrja në planin dhe zbatimin e programit të rigjenerimit;
- Ndihma e parë në rast lëndimi;
- Pjesëmarrja në përgatitjen dhe zbatimin e rehabilitimit/rikuperimit dhe monitorimi i progresit të lojtarëve gjatë fazës së rikuperimit dhe përdorimi i ndryshimeve në programet e trajtimit sipas nevojave të tyre;
- Zbatimi i procedurave terapeutike;
- Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për teknikat e stërvitjes së sigurt dhe përparimin e lojtarëve në të mirën e tyre fizike
- Bashkëpunimi me shtabin profesional dhe mjekësor për të koordinuar kujdesin e integruar të shëndetit për lojtarët
- Përgjegjës për punën e tij tek trajneri kryesor i Përfaqësueses.

### **Kualifikimet dhe Aftësitë:**

- Licencë në fizioterapi ose fusha të ngjashme, dhe përvojë pune në mjedisin e sportit, veçanërisht me ekipet sportive të nivelit të lartë;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi me lojtarët, trajnerët dhe shtabin profesional/mjekësor;
- Aftësi për të krijuar dhe zbatuar programe të trajtimit individual për nevojat e lojtarëve të ndryshëm;
- Njohuri të thella për anatominë dhe fiziologjinë e trupit njerëzor, si dhe për teknikat e terapisë fizike dhe rehabilitimit;
- Fleksibilitet për të punuar në një ambient të stresit të lartë dhe në situata të paparashikuara gjatë ndeshjeve dhe udhëtimeve të ekipit.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:







## TRAJNERI KONDICIONAL

Përgjegjës për planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e programit të trajnimit fizik dhe kushteve për lojtarët e Përfaqësueses. Kjo përfshin përmirësimin e formës fizike, forcimin muskujve, zhvillimin e shpejtësisë dhe fleksibilitetit, si dhe përgatitjen e lojtarëve për ndeshjet e rëndësishme ndërkombëtare.

- Merr pjesë aktive me trajnerin në krijimin e planit të punës së Përfaqësueses;
- Planifikimi dhe zbatim i programit të trajnimit fizik për lojtarët, duke përfshirë ushtrime të ndryshme për forcën, shpejtësinë, rezistencën dhe fleksibilitetin;
- Monitorimi i formës fizike dhe progresit të lojtarëve, dhe përdorimi i të dhënave për të ndryshuar programin e trajnimit sipas nevojave të tyre individuale;
- Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për nutricionin dhe planifikimin e dietës për të përmirësuar performancën dhe rikuperimin e lojtarëve;
- Bashkëpunimi me trajnerin shtabin profesional për të siguruar që programet e trajnimit të përshtaten me strategjinë e lojës dhe nevojat e ekipit;
- Bashkëpunimi me stafin mjekësor për të monitoruar dhe menaxhuar dëmtimet dhe rikuperimin e lojtarëve nga dëmtime të ndryshme;
- Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të rikuperimit dhe masazhit për të zvogëluar lodhjen dhe për të mbështetur rikuperimin e lojtarëve;
- Në marrëveshje me trajnerin, përgatit planet individuale të punës për kandidatët përfaqësues individual;
- Kujdeset për punë shtesë individuale me theks në aftësinë fizike;
- Në marrëveshje me trajnerin, drejton dhe zhvillon seancat stërvitore ose pjesë të seancave stërvitore të ekipit kushtuar përgatitjes fizike;
- Kujdeset për zhvillimin fizik individual të lojtarëve;
- Përgjigjet për punën e tij para trajnerit kryesor të Përfaqësueses

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:







## Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Përvojë pune si trajner kondicional i sportit, idealisht në basketboll ose sporte të ngjashme;
- Licencë ose certifikim në fushën e kushteve fizike ose sportive;
- Njohuri të thella për anatominë, fiziologjinë dhe biomekanikën e trupit njerëzor;
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe komunikimi, si dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor;
- Fleksibilitet për të adaptuar programet e trajnimit sipas nevojave dhe sfidave të ndryshme të ekipit;
- Njohuri të përdorimit të teknologjisë së fundit dhe mjeteve të monitorimit të performancës së lojtarëve.

## UDHËHEQËSI I DELEGACIONIT

Kryesues i delegacionit është përfaqësuesi zyrtar i FBK në garë. Në këtë kuadër, ai paraqet dhe përfaqëson interesat dhe kërkesat e FBK-së dhe Përfaqësueses para organizatorëve si dhe para zyrtarëve të FIBA-s në garë. Kjo përfshin organizimin, menaxhimin dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve jashtë fushës së lojës për ekipin në një nivel profesional dhe efikas.

## Detyrat kryesore:

- **Kontrollon nëse të gjitha çështjet që lidhen me pjesëmarrjen në garë janë rregulluar siç duhet**, që do të thotë se merr përsipër dokumentacionin e rregulluar tashmë, përfshirë:
  - o Licencat e lojtarëve;
  - o Lista e miratuar e lojtarëve;
  - o Formulari i regjistrimit të lojtarëve të rregulluar dhe plotësuar për ndeshjet;
  - o Informacion me shkrim nga organizatori në lidhje me garën (titujt, oraret,...);

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





- Dokumentacioni në lidhje me sigurimin e të gjithë anëtarëve të Përfaqësueses;
- Kontrollon gjithashtu nëse të gjithë anëtarët e delegacionit dhe veçanërisht lojtarët kanë pasaporta të vlefshme.
- Kontrollon dhe merr përsipër **çështjet financiare**, si:
  - Vërtetim/faturë për detyrimet e paguara ose para për shlyerjen e këtyre detyrimeve;
  - Paratë e destinuar për të mbuluar shpenzimet rrjedhëse si:
    - Pesha shtesë e bagazhit në transportin ajror;
    - Kostoja e blerjes së DVD-ve me regjistrime të ndeshjeve;
    - Shpenzimet e larjes;
    - Kostot e ushqimit gjatë udhëtimit;
    - Kostoja e çdo ushqimi dhe pije shtesë për ekipin;
    - Kosto të tjera të paparashikuara (rezervë);
    - Përgatit një raport të shkurtër financiar brenda dy javësh.
- **Pajisjet për ekipin:**
  - Kontrollon përshtatshmërinë e pajisjeve;
  - Kontrollon dhe ngarkon aksesorët dhe dhuratat e nevojshme;
  - Çdo lojtar dhe/ose zyrtar mban një grup fanellash në bagazhin e dorës në aeroport për shkak të problemeve të mundshme me bagazhin.
- **Sigurimi i kujdesit dhe mirëqenies së lojtarëve dhe shtabit**, duke përfshirë sigurimin e sigurisë dhe kujdesit mjekësor gjatë udhëtimeve dhe qëndrimeve të ekipit;
- Menaxhimi i situatave të papritura dhe menaxhimi i çështjeve të emergjencës që mund të dalin gjatë udhëtimeve dhe qëndrimeve të ekipit.
- **Detyrat gjatë garës:**
  - Pjesëmarrja në takimin e parë teknik;

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





- Paraqet të gjithë dokumentacionin pranë Komesarit të konkurrencës (licencat, pasaportat, Lista e miratuar e Lojtarëve, regjistrimi i lojtarëve për ndeshjen);
  - Prezanton pajisjet e Përfaqësueses;
  - Pajtohet për ngjyrën e fanellave në çdo ndeshje, nëse zgjedhja e ngjyrës anon nga rregullat (pajisje të lehta për ekipin e parë);
  - Paraqet vërtetimin e pagesës së detyrimeve ose shlyen këto detyrime dhe merr faturën;
  - Qartëson të gjitha pyetjet eventuale dhe mosmarrëveshjet e mundshme;
  - Ndërmjetësimi dhe përpunimi i kërkesave shtesë nga organizatorët (pas përzgjedhjes paraprake dhe vlerësimit të përshtatshmërisë);
  - Të kontrollojë përshtatshmërinë e flamurit dhe himnit në vendin e kampionatit;
  - Të informojë Menaxherin e Përfaqësueses/Koordinatorin për Përfaqësueset e Kategorive të Reja për çdo problem gjatë kampionatit;
  - Person kontaktues për mediat, prindërit dhe palët e tjera;
  - Kontaktimi me organizatorët gjatë përcaktimit të orarit të vakteve (rregullimi i çështjeve me ushqim dhe pije të mundshme shtesë), transporti, stërvitjet, etj.
- Të ndryshme:**
- Kujdeset për përshtatshmërinë e pajisjeve në ndeshje sipas rregullave të FIBA dhe FIBA të Evropës;
  - Merr pjesë në të gjitha takimet teknike;
  - Kujdeset për procedurat e mundshme të ankesës në rast të shkeljes së rregullave materiale të basketbollit sipas rregullave të FIBA-s;
  - Përkushtimi ndaj promovimit të imazhit dhe vlerave pozitive të Përfaqësueses në basketboll përpara publikut dhe mediave.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





### Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Përvojë e mëparshme në menaxhimin e ekipit ose organizatave sportive në një nivel profesional;
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe menaxheriale, duke përfshirë aftësinë për të menaxhuar buxhetin dhe resurset financiare;
- Komunikim i shkëlqyeshëm dhe aftësi diplomatike për të komunikuar me palët e ndryshme të interesit dhe përfaqësuesit e organizatave sportive ndërkombëtare;
- Fleksibilitet për të punuar në një ambient me nivel të stresit të lartë dhe për të menaxhuar situata të papritura në mënyrë efektive;
- Njohuri të përgjithshme të rregullave dhe procedurave të basketbollit në nivel ndërkombëtar është një avantazh;
- Aftësi të gjuhës së huaj (gjuha angleze) për të komunikuar me organizatat sportive të ndryshme dhe për të koordinuar aktivitetet ndërkombëtare të ekipit.

Miratuar në Prishtinë, më 08.05.2024

Arben FETAHU  
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës



#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

